



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 1314/1

Tirane, date 10/03/2016

Drejtuar: Z. BESNIK BUSHI  
SHOQERIA "RUBIN PETROL" SHA  
URA VAJGURE

BERAT

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV  
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE  
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR  
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE  
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.889 date 11.07.2005.

I nderuar z. Bushi,

Shoqëria "Rubin Petrol" sha është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.889 date 11.07.2005 për gurë gëlqerore, ne objektin "Guri i Bardhe", Ura Vajgurore, ne Qarkun Berat.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar, qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Leja juaj është dhëne për një afat fillestar për 10 vite dhe ky afat vlefshmërie ka mbaruar me date 11.07.2015. Ne zbatim te pikës nr.6 te nenit 24 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, ju keni aplikuar pranë Qendrës Kombëtare te Licencimit, për zgjatjen e këtij afati edhe për 10 vite te tjera, 180 dite përpara përfundimit te afatit fillestar.

Shoqëria juaj duhet te kishte plotësuar kërkesat e germës "d" te nenit 25 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar dhe VKM nr.362 date 29.04.2011 "Për miratimin e kriterëve dhe rregullave te transferimit, mënyrës se aplikimit për shtyrjen afateve dhe shndërrimit te lejeve minerare". Nga AKBN-ja jeni njoftuar me shkresën e saj nr.9501 date 26.10.2015 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit te aplikimit për shtyrje afati për Leje

minerare shfrytëzimi”, ku thuhet se duhet te depozitoni dokumentacionin qe mungonte sipas akteve ligjore e nënligjore qe përcaktojnë shqyrtimin e miratimin e kërkesës se zgjatjes se afatit te një leje minerare, gjë qe nga ana juaj nuk është bere.

Bazuar ne mangësitë e dokumentacionit, struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.1912 date 12.02.2016 ka dërguar Vendimi i Këshillit Teknik nr.427 date 19.01.2016 “Shqyrtimi dhe vlerësimin e dokumentacionit me nr. Aplikimi ne QKL nr. LC-0019-01-2015 date 09.01.2015 te subjektit “Rubin Petrol” sha, për shtyrje afati te lejes minerare te shfrytëzimit nr.889 date 11.07.2005 për gurë gëlqeror ne objektin “Guri i Bardhe”, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1311 date 16.02.2016, ne te cilin thuhet se është marre vendimi te mos miratohet shtyrja e afatit te kësaj leje, sepse nuk janë plotësuar kërkesat e ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar dhe akteve nënligjore qe kane dale ne zbatim te tij.

Mosplotësimi i informacioneve te kërkuara nga AKBN-ja si strukture përgjegjëse, është shkaku ligjor i përcaktuar ne germen “gj” te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, por duhet te theksojmë qe lejes te cilennr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar ju zotëroni i ka mbaruar edhe afati i vlefshmërisë.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.889 date 11.07.2005 për gurë gëlqeror, ne objektin “Guri i Bardhe”, Ura Vajguore, ne Qarkun Berat, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, **do te merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.889 date 11.07.2005 për gurë gëlqeror, ne objektin “Guri i Bardhe”, Ura Vajguore, ne Qarkun Berat.**

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN G.JIKNURI

